



**BASHKIA E TIRANËS**

**KRYETARI**

Nr. prot. 7215

Tiranë 05/02 / 2016

**Drejtuar:** **Aldrin Dalipi**  
Kryetar  
Këshilli Bashkiak Tiranë

**Lënda:** Dërgohet relacioni dhe projekt-vendimi për *“Disa ndryshime ne Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015 “Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës””*


Bashkëngjitur ju dërgojmë relacionin dhe projekt-vendimin për *“Disa ndryshime ne Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015 “Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës””*.


Ju urojmë punë të mbarë.

Me respekt,

Kryetar

**Erion Veliaj**





BASHKIA  
TIRANË

## RELACION

### PËR

#### **“DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 59, DATË 30.12.2015, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS””,**

Në mbështetje nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, nenit 35 dhe nenit 54, pikat 1, shkronja “f” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); nenit 128 të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative–territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, ju paraqesim propozimet për ndryshime si më poshtë vijon,

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, është miratuar paketa e re fiskale për vitin 2016 e në vijim.

Hyrja në fuqi e Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, solli disa reagime nga kategori të ndryshme të biznesit, të cilët paraqitën pretendimet dhe argumentet e tyre për barrën e rritur fiskale si pasojë e ndryshimeve që solli paketa e re.


Administrata e Bashkisë së Tiranës pas një sërë takimesh e negociatash me përfaqësues të këtyre kategorive i propozon Këshillit Bashkiak disa ndryshime në vendimin e sipërcituar, për të lehtësuar ngarkesën e tyre fiskale.

Së pari, po propozojmë ndryshimin e niveleve të “Taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e Paluajtshme”, sipas përcaktimeve të mëposhtme. Ky ndryshim vjen si rezultat i interpretimeve në raport me ndryshimet e fundit në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar) dhe vështirësitë e aplikimit në praktikë nga institucionet përgjegjëse të niveleve të miratuara.

Niveli i taksës sipas kategorive, është si vijon:

	Njësia Administrative Tiranë	Njësia Administrative Dajt, Farkë, Kashar Bërzhitë, Pezë, Baldushk, Vaqarr, Petrelë, Krabë, Ndroq, Shëngjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar
I. Ndërtesa banimi	1000	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	2000	300
II. Ndërtesa të tjera	1500	200

lekë/m<sup>2</sup>



BASHKIA  
TIRANË

*Së dyti*, propozojmë heqjen e tarifës së pastrimit “Vendosje tavolina ne muaj në hapësirat publike për tavolinë, për subjektet (bar, kafe, restorant, fast food, kafe internet etj te ngjashme me to”, me qëllim ekuilibrimin e ngarkesës së shtuar fiskale nëpërmjet aplikimit të tarifës së re për zënien e hapësirës publike.

Nivelet e tjera të tarifës së pastrimit sipas kategorive e nënkategorive dhe llojit të biznesit, mbeten të pandryshuara.

*Së treti*, po propozojmë ndryshimin e ndarjes territoriale sipas zonave A, B dhe C për efekt të aplikimit të “Tarifës për zënien e hapësirave publike”, i cili mundëson ngushtimin e zonës A, ku aplikohen tarifatat më të larta dhe kthimin e tyre në zona B, ku tarifa është gjysma e nivelit të zonës A. Ky propozim mundëson aplikimin e tarifës në përputhje me zhvillimin ekonomik të zonës respektive, dhe uljen e ngarkesës fiskale për bizneset që ushtrojnë aktivitetin në zona me tregues ekonomikë më të dobët.

Ndarja e re përcaktohet në Shtojcën A bashkëlidhur projektvendimit.

Gjithashtu, për arsye se, detyrimet për muajt Janar dhe Shkurt 2016, në lidhje me tarifën për zënien e hapësirave publike, janë njoftuar së bashku dhe krijojnë një ngarkesë të lartë fiskale në një periudhë të shkurtër, Bashkia e Tiranës mori në konsideratë kërkesën e përfaqësisë së bizneseve për të mos i aplikuar tarifatat e reja deri në datën 1 Mars 2016 dhe të vijojë me nivelet e mëparshme, përjashtimisht dhe vetëm për këtë periudhë.

Për sa më sipër, relacioni dhe projekt vendimi i paraqitet për shqyrtim dhe miratim Këshillit Bashkiak të Tiranës.

Duke shprehur në miratimin Tuaj.

**Jonida Halili**

Drejtori i Përgjithshme i Menaxhimit Financiar

**Arli Naska**

Drejtori i Përgjithshëm i Taksave dhe Tarifave Vendore

**Itena Ndroqi**

Drejtor i Përgjithshëm Juridik, Aseteve dhe Licensimit

**Arbian Mazniku**

Zv. Kryetar

**Arsela Gjonaj**

Juristi i Këshillit Bashkiak

**Behar Zeneli**

Sekretar i Këshillit Bashkiak



BASHKIA  
TIRANË

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M (Projekt)**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_ / \_\_\_ /2016

**PËR**

**“DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 59, DATË  
30.12.2015, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË  
QYTETIN E TIRANËS”,**

Në mbështetje nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, nenit 35 dhe nenit 54, pikat 1, shkronja “f” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); nenit 128 të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë ndryshimet në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, si vijon:

(i) Pika I.dh, ”Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e Paluajtshme”, ndryshon si më poshtë:

Niveli i taksës sipas kategorive, është si vijon:

lekë/m<sup>2</sup>

	Njësia Administrative Tiranë	Njësia Administrative Dajt, Farkë, Kashar Bërzhitë, Pezë, Baldushk, Vaqarr, Petrelë, Krabë, Ndroq, Shëngjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar
I. Ndërtesa banimi	1000	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	2000	300
II. Ndërtesa të tjera	1500	200



BASHKIA  
TIRANË


(ii) Në pikën II.a “Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave”, niveli i taksës sipas kategorive ndryshon si më poshtë:

Nr	Kategorite	BV		BM	VIP
		Xhiro 0-2 milion	Xhiro 2-8 milion		
		Leke/vit	Leke/vit		
<b>FAMILJARET (për Familje)</b>					
<b>I</b>	<b>Qyteti Tiranes</b>			<b>5,000</b>	
	NJA = Dajt, Farke, Kashar,			<b>2,000</b>	
	NJA = Berzhite, Baldushk, Petrele, Vaqarr, Peze, Ndroq, Krabe, Shengjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar			<b>1,000</b>	
<b>II</b>	<b>BIZNESI</b>				
<b>II.1</b>	<b>SHITJE ME PAKICË</b>				
	Mish, peshk	3,500	10,000	80,000	100,000
	Bulmet, Fruta, perime, ushqimore	3,500	10,000	60,000	81,000
	Artikujt industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, etj të ngjashme me to).	3,500	10,000	30,000	50,000
	Bar kafe	3,500	10,000	60,000	80,000
	Restorant, fast food etj te ngjashme me to	3,500	12,000	74,000	94,000
	Pub, diskoteka etj te njashme	3,500	12,000	80,000	100,000
	Kafe internet, lojëra fati, qendra interneti	3,500	10,000	20,000	38,000
	Njesi tregtimi lendesh djegese, hidrokarbure etj te ngjashme me to.	3,500	10,000	44,000	64,000
	Shitje produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to (depo farmaceutike te regjistruara si biznes i vogël)	3,500	10,000	20,000	38,000
	Etj te ngjashme me to	3,500	10,000	20,000	38,000
<b>II.2</b>	<b>SHITJE ME SHUMICË</b>				
	Magazina, dyqane, etj te cilat realizojnë shitje me shumice	3,500	12,000	74,000	94,000
<b>II.3</b>	<b>NJESI PRODHIMI</b>				
	Perpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie letre, kartoni, plasmasi etj te ngjashme me to	3,500	10,000	170,000	360,000
	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gelqereje, nyje inerte etj, te ngjashme me to	3,500	10,000	170,000	360,000
	Prodhime ushqimore, buke, embelsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh etj te ngjashme me to.	3,500	10,000	170,000	340,000
	Prodhim konfeksione, etj te ngjashme me to.	3,500	7,000	170,000	360,000
	Prodhim, perpunim vajrash, naftë , gazi e nenprodukte etj te ngjashme me to.	3,500	7,000	170,000	360,000
	Impiante, territore per therrjen e kafshëve etj te ngjashme me to.	3,500	7,000	170,000	360,000
	Shtypshkronja etj te ngjashme me to.	3,500	7,000	170,000	360,000
	Impiante, linja për prodhim dhe përpunim e produkteve ushqimore ose të tjera.	3,500	7,000	170,000	360,000
	Prodhim perpunim produkte farmaceutike etj te ngjashme me to.	3,500	7,000	170,000	360,000
<b>II.4</b>	<b>SUBJEKTE NDERTIMI</b>				
	Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, objekte banimi, shërbimi, të përbëra etj të ngjashme me to ,	3,500	30,000	300,000	450,000
	Rikonstruksione te pjeseshme	3,500	15,000	150,000	224,000
	Subjekte Ndertuese per selinë administrative	3,500	15,000	36,000	60,000
	Subjektet e Karrierave per prodhim gurri, inerte etj te ngjashme me to,	3,500	15,000	100,000	100,000



BASHKIA  
TIRANË

II.5	NJESI SHERBIMI				
	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, radio televizore, frigorifere, lavatriçe, manjetofon, paisje fonie e te tjera te ngjashme me to.	3,500	10,000	50,000	60,000
	Sherbime fotokopimit, sallon bukurie, autoservise, kurse per makina (autoshkolla) per traktore, per kompjuter e per parukeri, agjensi doganore, agjensi kembimi valute, agjensi turizmi,, konviktet pikat e sherbimit te makinave (autoservis), parkimi i makinave, agjenci transporti, lavanterite, pastrimi kimik, sherbime te rojeve civile, sallat e lojrave te ndryshme (gjimnastike, aerobie, cirqe, kende lojrash per femije, ping pong, etj.) e te tjera sherbime te ngjashme me sherbimet e lartepmendura.	3,500	10,000	50,000	70,000
	Shtëpi botuese, biblioteka	3,500	10,000	50,000	70,000
	Hotele, motele (leke/dhome ne vit)	3,500	10.000 + 1.000	30.000 +1.500	60.000 +2.000
	Njësi shërbimi marangoz, rrobaqepës,këpucar, floktore, orëndreqës etj	3,500	7,000	30,000	50,000
	Komplekse sportive, palestra, fitnes,pishina, qendra e institute kerkimore-shkencore,salla koncerte-mbledhje e videoteka	3,500	10,000	50,000	70,000
	Lojra me kompjuter, lojra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura	3,500	10,000	20,000	50,000
	Institucionet jopublike te edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet), shërbimet ne klinikat e specialiteteve te ndryshme mjekësore, shërbimet ne laboratorë diagnostifikimi	3,500	10,000	50,000	70,000
	Njësi të tjera (që nuk përfshihen në kategoritë dhe nënkategoritë si më lart)	3,500	10,000	30,000	50,000
<b>II.6</b>	<b>SHOQATA, FONDACIONE, ENTE TE NDRYSHME SHTETERORE, ORGANIZATA JOQEVERITARE</b>		10,000		
<b>II.7</b>	<b>PROFESIONE TE LIRA</b>				
	Avokatet, noter,mjek, mjeku-laborant, stomatologu, Farmacisti, ekonomisti kontabël te miratuar, eksperti kontabël te autorizuar, mësuesit, veterinerët, agronomit, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, e te tjera profesione te lira te cilat ushtrohen ne njësi fikse apo ne ambiente te ndryshme e të tjerë të ngjashëm me to.	3,500	10,000	30,000	50,000
	Galeritë e artit te piktoreve, skulptoreve dhe artisteve te tjerë qe prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike	3,500	10,000	30,000	50,000
	Institucionet jopublike te edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet), , shërbimet ne klinikat e specialiteteve te ndryshme mjekësore, shërbimet ne laboratorë diagnostifikimi etj ne rastet kur nuk e kalojnë kufirin e regjistrimit ne TVSH.	3,500	12,000	50,000	70,000
<b>II.8</b>	<b>AMBULANT</b>				
	Subjekte qe nuk kane një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante ne tregje publike dhe private.		3,000		
<b>II.9</b>	<b>TRANSPORT</b>				
	Transport pasagjerësh				
	Automjet deri 5 vende	3,500	7,000	20,000	48,000
	Automjet 6-9 vende	3,500	7,000	20,000	48,000
	Automjet 10-25 vende	3,500	7,000	20,000	48,000
	Automjet 26-42 vende	3,500	7,000	20,000	48,000
	Automjet mbi 42 vende	3,500	7,000	20,000	48,000



BASHKIA  
TIRANË

Transport Mallrash					
Automjet deri 2 tonë	3,500	7,000	20,000	48,000	
Automjet 2-5 tonë	3,500	7,000	20,000	48,000	
Automjet 5-10 tonë	3,500	7,000	20,000	48,000	
Automjet 10-16 tonë	3,500	7,000	20,000	48,000	
Automjet mbi 16 tonë	3,500	7,000	20,000	48,000	

(iii) Në pikën II.b, "Tarifa për zënien e hapësirave publike", pas "Pagesa e Tarifës për zënien e hapësirës publike:" paragrafi c), shtohen paragrafët si më poshtë:

- d) Përrjashtimisht dhe vetëm për periudhën Janar dhe Shkurt 2016, niveli i tarifës do të aplikohet sipas pikës 1.ë të Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 3, datë 05.02.2007 "Për sistemin e taksave e tarifave vendore në qytetin e Tiranës" (i ndryshuar). Afati i pagesës për këtë periudhë shtyhet deri më 31 Prill 2016.
  - e) Për aplikimin dhe zbatimin e nivelit të "Tarifës për zënien e hapësirave publike" ndarja territoriale në zonë A, B dhe C, përcaktohet në Shtojcën A bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Pas pikës 4, shtohet pika 4/1 si më poshtë:
- 4/1.Përrjashtimisht dhe vetëm për vitin fiskal 2016, të gjitha detyrimet vendore të cilat duhet të paguhen brenda datës 20 Prill 2016 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, afati i pagesës shtyhet deri më datë 30 Maj 2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Njësitë Administrative, Institucionet dhe Ndërmarrjet e Varësisë së Bashkisë së Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

ALDRIN DALIPI



# MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISE TIRANE

Z. Erion VELIAJ



### SPECIFIKIME

#### ZONA - A:

- Rrugët kulturore të Zonës - A, janë:
- Bulevardi "HAN DARR"
- Rruga "MUSLIM SHIRI"
- Rruga "KASIM PASHA"
- Rruga e "DUMKESIT"
- Bulevardi "ZOGU I FARE"
- Shpall "SHENDERREJ"
- Rruga "DIMITRI BUKURIU"
- Bulevardi "DESMARDEI E KOHARIT"
- Rruga e "ELBASANI"
- Rruga "SAMI FRASHERI"
- Rruga "KURBAN GALIPI"
- Rruga "DEBIZANDE E "SHKURIT"

Të gjitha rrugët e përfshira brenda zonave të përcaktuara do të gjënohen në specifikimet teknike dhe në hartën e detajuar.

#### ZONA - B:

- Rrugët kulturore të Zonës - B, janë:
- Rruga "TEODOR KECI"
- Rruga "DIMITRI HOXHA"
- Rruga "ASIM VOJCI"
- Rruga "TAPAKU I PELLA"
- Rruga e "ELBASANI"
- Rruga "UNAJA E MADHE NE NDERITIM"

Të gjitha rrugët e përfshira brenda zonave të përcaktuara do të gjënohen në specifikimet teknike dhe në hartën e detajuar.

#### ZONA - C:

- Kufiri i Zonës - C, është:
- Kufiri I SHYLLJE VEPRDHE E IRANES
- Rrugët kulturore të Zonës - B

Të gjitha rrugët e përfshira brenda zonave të përcaktuara do të gjënohen në specifikimet teknike dhe në hartën e detajuar.

### LEGJENDA

	ZONA - A
	ZONA - B
	ZONA - C